

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) и член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по наставниот предмет *албански јазик и литература* за III (трета) година образование од средното стручно образование со четиригодишно траење.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Me disajnim modular

Për vitin III

Të gjithë profilet e arsimit /kualifikimet

Të gjithë drejtimet/sectorët

Shkup, 2019

Emri i programit mësimor	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Lloji i programit mësimor	Obligativ
Vlera e kreditit e programit mësimor	<p>ECVET – European Credit system for Vocational Education and Training Transfer Kredit Sistemi European për Arsimim dhe Trajnim Profesional 7 ECVET kredite (5 kredite+2 kredite plotësuese)</p> <p>(Numri 5 përcakton kredi të cilat arrihen me pjesëmarrjen në orë të kësaj lëndë mësimore në kuadër të modulit të përgjithshëm arsimor, angazhimin në orë dhe pjesëmarrje në procesin e nxënies dhe mësimin. 2(dy) kredi tjera kanë të bëjnë në pjesëmarrje dhe aktivitete të cilat nxënësit i realizojnë jashtë orëve mësimore në funksion të arritjeve të njohurive të kësaj lëndë mësimore).</p> <p>Dy kredi përfshijnë 50 orë aktivitete të nxënësit (10 orë ushtrime dhe përgatitje për punime me shkrim, 20 orë lexim të veprave dhe lektyrave për përpunim, 20 orë mësim të pavarur (përgatitje të prezantimeve me gojë dhe me shkrim, detyra shtëpie, dhe përgatitje të eseve).</p>
Drejtimi	Të gjithë drejtimet
Sektori	Të gjithë sektorët
Profili arsimor	Të gjithë profilet e arsimit
Emri dhe niveli i kualifikimit	<p>Të gjithë kualifikimet</p> <p>IV niveli</p>
Viti mësimor	III (i tretë)
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	3/108

<p>Qëllimet e programit mësimor</p>	<p>Qëllimet e përgjithshme:</p> <p>Të zgjerohen dhe të përthellohen njohuritë për gjuhën standarde shqipe si mjet komunikimi.</p> <p>Të zgjidhen, të rezimohen dhe të zbatohen dituritë e arritura në kontestin gjuhësor përkatës.</p> <p>Të paraqitet hierarkia dhe lidhshmëria e njësive gjuhësore nga fonema deri te fjalia dhe të potencohet rëndësia e tyre në komunikimin gjuhësor.</p> <p>Të zbatohen në të shprehurit me gojë dhe me shkrim rregullat gjuhësore dhe konstruktionet karakteristike për gjuhën e standarde shqipe.</p> <p>Të zbatohen shkathtësitë për analizë dhe interpretim të pavarur të veprave letrare nga autorë, epoka dhe drejtime të ndryshme.</p> <p>Të aftësohen që në mënyrë kritike dhe me argumente të vlerësohen veprat letrare, situatat problemore, manifestimet shoqërore, kulturore e artistike dhe evenimentet përmes qëndrimeve dhe mendimeve vetjake.</p>
<p>Njësia modulare e programit mësimor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë • Letërsi <p>Shënim: Modulet gjuhësore dhe letrare gjegjësisht përmbajtjet në të dy modulet duhet të kombinohen ndërmjet veti. Me këtë do të arrihet tërësia në raport me qëllimet e përgjithshme të lëndës si dhe arritja e rezultateve të parashikuara sipas kritereve të dhëna. Çdo orë mësimore edhe më tutje do të ketë qëllimin e vet, i cili në do të kombinohet me përmbajtjet tanimë të mësuara nga njëri apo tjetri modul. Njëkohësisht ju sugjerojmë se orari dhe organizimi i mirë i përmbajtjeve të dhëna do të ndikon në realizimin e orëve, gjegjësisht do të ndikon në suksesin e nxënies në mësim.</p>
<p>Kushtet tekniko-materiale dhe hapësinore.</p>	<p>Për arritjen e qëllimeve në lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi duhet që të sigurohen mjete mësimore në kabinete ose klasa, fond i librave për bibliotekë, qasje në internet, pajisje kompjuterike, LCD projektor etj. Për realizim të plotë dhe të suksesshëm të programit mësimor duhet të organizohen edhe aktivitete që e ndërrojnë vendin e realizimit të orës/orëve mësimore (institucione të kulturës, manifestime dhe festivale: letrare, teatrore dhe filmike).</p>
<p>Normativi për kuadrin mësimor</p>	<p>Lëndën Gjuhë shqipe dhe letërsi në shkollat e mesme profesionale mund ta ligjërojnë mësimdhënësit që kanë kryer:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS; - Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.

Njësia modulare: GJUHË				
Nr. rend.	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret e vlerësimit *
1	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
1.1.	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë veçoritë kryesore që e karakterizojnë zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në etapën e dytë; - të tregojë çfarë e karakterizon zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në fazën e parë dhe të dytë; - të tregojë veçoritë kryesore të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në fazën e tretë. 	<p>Zhvillimi i gjuhës shqipe gjatë periudhës midis dy luftërave botërore (etapa e dytë)</p> <p>Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916)</p> <p>Kongresi Arsimor i Lushnjës (1923)</p> <p>Dekreti shtetëror për caktimin e gegërishtes së mesme gjuhë letrare zyrtare (1923)</p> <p>Karakteristikat e zhvillimit të shqipes letrare në vitet 1939 - 1944</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Me anë formash të ndryshme të mësimdhënies nxënësit njihen drejtpërdrejt me vendimet e Komisionit letrare të Shkodrës.</p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njihen e përballen me veprimtaritë, publikimet, revistat dhe organet e tjera të shtypit të kësaj periudhe.</p> <p>Duke përqasur shkrime të ndryshme të nxjerra nga periodikët e kohës ilustrohen përpjekjet, qëndrimet dhe pikëpamjet e veprimtarëve të shquar lidhur me gjuhën letrare shqipe.</p> <p>Metodat: metoda diakronike, metoda audio-vizuale, metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.1.1: të përmendë e të sqarojë çfarë u vendos në Komisionin Letrare Shqipe të Shkodrës;</p> <p>1.1.2: të trajtojë rëndësinë e vendimeve të Kongresit të Lushnjës për zhvillimin e gjuhës shqipe;</p> <p>1.1.3: të tregojë si u vendos të bëhet gjuhë zyrtare e përbashkët e folmja e Elbasanit.</p>

* Janë përfshirë standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të nxënit sipas të cilëve përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			metoda e analizës; metoda e krahasimit.	
1.2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë faktorët themelorë që ndikuan në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe gjatë etapës së tretë; - të shpjegojë çfarë e karakterizon zhvillimin e gjuhës letrare shqipe gjatë periudhës 1945-1967 - të tregojë çfarë u vendos në Konsultën gjuhësore të Prishtinës (1968) 	<p>Zhvillimi i gjuhës letrare shqipe në etapën e tretë</p> <p>Konferenca kombëtare për drejtshkrimin e shqipes (1953)</p> <p>Fjalori i gjuhës shqipe (1954)</p> <p>Konferenca I e studimeve albanologjike në Tiranë (1962)</p> <p>Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968)</p> <p>Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972)</p> <p>Konceptet: konferencë kombëtare, konsultë gjuhësore; rezolutë e kongresit të drejtshkrimit, drejtshkrimi i gjuhës shqipe</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njihen e përballen me rrethanat, faktorët dhe ngjarjet kryesore që i paraprinë Kongresit të Drejtshkrimit;</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj nga Konferenca kombëtare (1953), Fjalori i gjuhës shqipe (1953), Konferenca I e studimeve albanologjike dhe Konsulta gjuhësore e Prishtinës në mënyrë që nxënësit, nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta, t'i identifikojnë dhe t'i shqyrtojnë ngjarjet kryesore përgatitore që sollën Kongresin e Drejtshkrimit;</p> <p>Metodat: metoda diakronike, metoda audio-vizuale, metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e analizës; metoda e krahasimit.</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.2.1: të numërojë e të sqarojë faktorët themelorë që ndikuan në zhvillimin e shqipes letrare në etapën e tretë;</p> <p>1.2.2: të përmendë e të tregojë ngjarjet kryesore me rëndësi për gjuhën shqipe para vitit 1972;</p> <p>1.2.3: të shpjegojë si u zhvillua dhe çfarë u vendos në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.</p>

2	Leksikologji e leksikografi			
2.1.	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë konceptin për leksikun dhe objektin e leksikologjisë; - të dallojë leksikun e gjuhës letrare nga leksiku i përgjithshëm; - ta përcaktojë fjalën si njësi leksikore dhe të tregojë veçoritë kryesore të saj; - të tregojë vlerat kryesore të fjalës si njësi leksikore; - të përcaktojë lidhjet kuptimore të fjalëve në gjuhën shqipe (sinonimet, antonimet, homonimet); - të bëjë dallimin e leksikut të gjuhës shqipe sipas burimit (shtresa vetjake dhe shtresa e huazuar) dhe sipas përdorimit (leksik i vjetruar dhe leksik i sotëm); - të përcaktojë strukturën 	<p>Njohuri të përgjithshme për leksikologjinë</p> <p>Fjala si njësi bazë e leksikut</p> <p>Fjala dhe veçoritë e saj</p> <p>Vlerat kryesore të fjalës</p> <p>Lidhjet kuptimore të fjalëve në gjuhën shqipe</p> <p>Ndarja e leksikut të gjuhës shqipe sipas burimit dhe përdorimit</p> <p>Struktura kuptimore e fjalëve të shumëkuptimshme</p> <p>Profesionalizmat dhe terminologjia</p> <p>Njësitë frazeologjike</p> <p>Leksikografia dhe fjalori</p> <p>Konceptet: leksik, leksikologji,</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Bëhet ndërlidhja funksionale me përmbajtjet mësimore të fushës tematike Morfologji për të përsëritur përmbajtjet lidhur me strukturën morfologjike të fjalës me theks të veçantë të temat fjalëformuese dhe prapashtesat fjalëformuese. Po kështu rimerren edhe njohuritë lidhur me fjalën si njësi leksikore.</p> <p>Përgatiten ushtrime për të përcaktuar veçoritë dhe vlerat kryesore të fjalës si njësi leksikore duke i pasqyruar edhe sqarimet përkatëse për secilën nëndarje të tyre veç e veç me anë shembujsh domethënës.</p> <p>Me anë tekstesh të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre të përditshme, përkatësisht tekste që kanë të bëjnë me profesionin e tyre të ardhshëm, nxënësit njihen me lidhjet kuptimore që mund t'i kenë fjalët me njëra-tjetrën (sinonimet, antonimet e homonimet), me shtresat e leksikut të gjuhës shqipe sipas burimit dhe sipas përdorimit të tij. Me anë pyetjesh të fokusuara nxirren në pah njohuritë e tyre për</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>2.1.1: ta përkufizojë ç'është leksiku kush e studion atë;</p> <p>2.1.2: të përcaktojë fjalën si njësi leksikore dhe të vërë në dukje dallimet midis leksikut të përgjithshëm dhe leksikut të shqipes standarde;</p> <p>2.1.3: të tregojë veçoritë dhe vlerat kryesore të fjalës si njësi leksikore;</p> <p>2.1.4: të përcaktojë lidhjet kuptimore të fjalëve (sinonime, antonime e homonime);</p> <p>2.1.5: të dallojë shtresimet e leksikut sipas burimit dhe sipas përdorimit të tij;</p> <p>2.1.6: t'i dallojë fjalët që kanë shumë kuptime dhe të shpjegojë me shembuj kuptimin leksikor, kuptimin e figurshëm dhe kuptimet e tjera të tyre;</p>

	<p>kuptimore të fjalëve polisemike (kuptimin leksikor dhe kuptimin e figurshëm);</p> <p>- të dallojë fjalën si njësi leksikore nga profesionalizmat dhe nga leksiku terminologjik;</p> <p>- të përcaktojë njësitë frazeologjike dhe të tregojë veçoritë kryesore të tyre;</p> <p>- t'i dallojë llojet e fjalorëve dhe t'i shfrytëzojë si duhet ata.</p>	<p>vlerë e fjalës, përmbajtje / formë e fjalës; lidhje kuptimore e fjalëve: sinonime, antonime, homonime; shtresë e leksikut, arkaizma, neologjizma; strukturë kuptimore; fjalë të shumëkuptimshme, kuptim leksikor, kuptim i figurshëm; fjalë profesionale, leksik terminologjik; frazeologji, frazeologjizëm; leksikografi, fjalor (shpjegues, dygjuhësh enciklopedik, terminologjik, frazeologjik etj.)</p>	<p>shtresën vetjake dhe të huazuar si dhe për leksikun e vjetruar dhe leksikun e sotëm të gjuhës shqipe.</p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njihen e përballen me veçoritë e strukturës kuptimore të fjalëve me shumë kuptime duke marrë shembuj konkretë për të ilustruar kuptimin themelor (leksikor) dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve polisemike, ose për të vënë në dukje profesionalizmat dhe leksikun terminologjik.</p> <p>Si veprimtari përgatitore për këtë tërësi tematike mësimdhënësi mund t'u japë detyrë nxënësve të kërkojnë nëpër fjalorë të ndryshëm ose nga letërsia artistike fjalë e njësi të shumta frazeologjike për të sqaruar në klasë konceptet përkatëse dhe për t'i ilustruar me anë shembujsh konkretë dhe në mënyrë tabelore.</p> <p>Nxënësit nxiten të lexojnë tekste të ndryshme artistike, të shfrytëzojnë literaturë profesionale e shkencore si dhe mësohen si të shfrytëzojnë fjalorët e llojeve të ndryshme për nevojat e tyre njohëse praktike.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog,</p>	<p>2.1.7: t'i sqarojë dallimet ndërmjet fjalës si njësi leksikore dhe profesionalizmave e leksikut terminologjik;</p> <p>2.1.8: të shpjegojë njësitë frazeologjike dhe veçoritë kryesore të tyre;</p> <p>2.1.9: të përcaktojë leksikografinë dhe fjalorin dhe t'i përdorë tipat e ndryshëm të fjalorëve.</p>
--	---	--	---	--

			dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës, metoda e ilustrimit, metoda e hulumtimit.	
3.	Morfologji e morfosintaksë			
3.1.	Nxënësi do të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë te foljet format e zgjedhimit vepror dhe ato të zgjedhimit jovepror; - të dallojë foljet që hyjnë në zgjedhimin e parë, në zgjedhimin e dytë dhe në zgjedhimin e tretë; - të bëjë dallimin midis foljeve të rregullta dhe foljeve të parregullta; - t'i tregojë si ndërtohen format e zgjedhimit vepror të foljeve në të gjitha kohët e mënyrat; - të tregojë si ndërtohen format joveprore e foljeve; - të përcaktojë kuptimin dhe format e pashtjelluara të foljes. 	Folja <p>Zgjedhimi i foljeve (vepror dhe jovepror)</p> <p>Ndarja e foljeve në zgjedhime dhe foljet e parregullta</p> <p>Kuptimet dhe format e zgjedhimit vepror të foljeve: mënyra dëftore (koha e tashme, koha e shkuar dhe koha e ardhme) dhe habitore (koha e tashme, koha e shkuar); mënyra lidhore (koha e tashme, kohët e shkuara) dhe mënyra kushtore; mënyra dëshirore (koha e tashme dhe koha e kryer) dhe mënyra urdhërore</p> <p>Zgjedhimi jovepror</p>	Veprimtaritë: <p>Me anë tekstesh të larmishme që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre të përditshme, përkatësisht tekstesh që kanë të bëjnë me profesionin e tyre të ardhshëm përcaktohen dhe veçohen foljet e zgjedhimit vepror dhe foljet e zgjedhimit jovepror. Me anë pyetjesh të fokusuara nxirren në pah njohuritë e tyre për foljen në përgjithësi dhe për kategoritë gramatikore të tyre.</p> <p>Bëhen ushtrime për të ilustruar me shembuj nga tekstet e ndryshme dallimin e foljeve të rregullta nga foljet e parregullta duke shpjeguar ndryshimin e temave të tyre.</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta t'i vënë re dhe t'i shpjegojnë kuptimet</p>	Nxënësi mund: <p>3.1.1: të dallojë e të shpjegojë format e zgjedhimit vepror dhe jovepror;</p> <p>3.1.2: të bëjë ndarjen e foljeve në zgjedhime dhe t'i shpjegojë ato;</p> <p>3.1.3: të identifikojë foljet e parregullta dhe t'i përdorë drejt format e tyre nëpër kohë e mënyra;</p> <p>3.1.4: të bëjë ndarjen e mënyrave të foljes sipas kuptimeve modale të tyre;</p> <p>3.1.5: të përshkruajë e të tregojë kuptimet dhe format e zgjedhimit vepror dhe jovepror të foljeve në të gjitha kohët e</p>

		<p>Format e pashtjelluara</p> <p>Konceptet: zgjedhim (zgjedhim vepror, zgjedhim jovepror); folje supletive, josupletive; formë e shtjelluar, formë e pashtjelluar</p>	<p>dhe format e ndryshme që marrin foljet kur përdoren nëpër kohë e mënyra të ndryshme</p> <p>Parapëlqehet që me anë të një skeme të përgatitur me disa kolona me shembuj ilustrimi të konkretizohet ndarja e foljeve në zgjedhime, pastaj zgjedhimi vepror e jovepror, foljet e parregullta si dhe format e pashtjelluara dhe komentimi i tyre përkatës.</p> <p>Metodat: metoda e deduksionit, metoda e induksionit, metoda e ndërveprimit / metoda e komunikimit (monolog, dialog e bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe e sintezës</p>	<p>mënyrat;</p> <p>3.1.6: t'i përdorë drejt format vetore të foljeve në situata ligjërimore të ndryshme dhe t'i zbatojë ashtu si duhet format e tyre të shtjelluara e të pashtjelluara;</p>
3.2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë kuptimin e ndajfoljeve dhe të tregojë dallimin e saj nga pjesët e tjera të pandryshueshme; - të tregojë klasifikimin kryesor të ndajfoljeve dhe llojet e tyre; - të tregojë shkallët e ndajfoljeve; - përcaktojë funksionet sintaksore 	<p>Pjesët e pandryshueshme</p> <p>Ndajfolja</p> <p>Kuptimi dhe klasifikimi i ndajfoljeve</p> <p>Kategoria gramatikore e shkallës të ndajfoljet</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta t'i vënë re dhe t'i shpjegojnë kuptimet dhe llojet e ndryshme të ndajfoljeve.</p> <p>Nëpërmjet një tablele të përgatitur me disa kolona me shembuj ilustrimi të konkretizohet ndarja e ndajfoljeve në përcaktore e rrethore dhe pasqyrohen llojet e tyre, pastaj shpjegohet edhe përdorimi ose</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>3.2.1: të përcaktojë ndajfoljet e të shpjegojë dallimin e tyre nga pjesët e tjera të pandryshueshme të ligjëratës;</p> <p>3.2.2: të bëjë klasifikimin e ndajfoljeve dhe të japë sqarime për to;</p> <p>3.2.3: të përdorë e të dallojë ndajfoljet sipas kategorisë</p>

	të ndajfoljeve.		<p>mospërdorimi i tyre në shkallë të ndryshme në përqasje me shkallën te mbiemrat.</p> <p>Bëhen ushtrime për të ilustruar me shembuj nga tekstet e ndryshme formimin e emrave abstraktë nga disa ndajfolje, ashtu sikundër edhe nga mbiemrat (krah. <i>mirë</i> – mirësi sikundër <i>i bardhë</i> – bardhësi etj.).</p>	<p>gramatikore të shkallës;</p> <p>3.2.4: t'i përdorë drejt ndajfoljet në kontekste të ndryshme ligjërimore.</p>
4	Sintaksa e fjalisë			
4.1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë rrethanorin dhe të tregojë llojet e tij kryesore; - të tregojë secilin nga llojet e rrethanorëve dhe shprehjen e tij; - të identifikojë gjymtyrën e krahasimit dhe shprehjen e saj në fjali. 	<p>Rrethanori dhe llojet e tij</p> <p>Gjymtyra e krahasimit</p> <p>Konceptet: rrethanori: i vendit, i kohës, i shkakut, i qëllimit, i kushtit, i lejimit, i mënyrës, i sasisë; gjymtyra e krahasimit</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë rrethanorin në fjali, të përcaktojnë llojin e tij dhe të tregojnë me se shprehet ai.</p> <p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme të morfologjisë (ndajfolja, emri, mbiemri etj.) dhe shprehjen e rrethanorëve e të gjymtyrës së krahasimit.</p> <p>Bëhet paraqitja skematike e llojeve të</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>4.1.1: të dallojë rrethanorin nga gjymtyrët e tjera të dyta dhe të tregojë me se shprehet ai në fjali;</p> <p>4.1.2: të identifikojë llojin e rrethanorit dhe me se shprehet ai;</p> <p>4.1.3: të përcaktojë gjymtyrën e krahasimit dhe të shpjegojë shprehjen e saj.</p>

			<p>rrethanorëve dhe gjymtyrës së krahasimit duke vënë në pah veçoritë e tyre sintaksore.</p> <p>Metodat: monolog – dialog; metoda e demonstrimit / metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	
4.2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë përcaktorin dhe lidhjen e tij me gjymtyrët e tjera në fjali; - të tregojë ndarjen e përcaktorëve sipas lidhjes sintaksore të tyre; - të përcaktojë ndajshtimin dhe të tregojë shprehjen e tij në fjali; - të identifikojë përcaktorin kallëzuesor dhe të tregojë veçoritë dhe llojet e tij. 	<p>Përcaktori dhe llojet e tij</p> <p>Ndajshtimi</p> <p>Përcaktori kallëzuesor</p> <p>Konceptet: përcaktor: me përshtatje, me drejtim, me bashkim; ndajshtim; përcaktor kallëzuesor: i kryefjalës, i kundrinës</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë përcaktorin në fjali, të dallojnë atë nga fjalët përcaktuese dhe të tregojnë nga cilat gjymtyrë varet.</p> <p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme për togfjalëshin (lidhjet gramatikore të fjalëve) dhe llojet e përcaktorëve sipas lidhjes sintaksore.</p> <p>Bëhet paraqitja skematike e llojeve të përcaktorëve dhe të ndajshtimit e përcaktorit kallëzuesor duke vënë në pah veçoritë e tyre sintaksore.</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>4.2.1: të dallojë përcaktorin nga fjalët përcaktuese dhe nga gjymtyrët e tjera të dyta;</p> <p>4.2.2: të identifikojë llojin e përcaktorit dhe të tregojë me se shprehet ai;</p> <p>4.2.3: të bëjë dallimin e përcaktorit nga ndajshtimi e përcaktori kallëzuesor dhe të shpjegojë veçoritë e tyre.</p>

			Metodat: monolog – dialog; metoda e demonstrimit / metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës	
4.3	Nxënësi do të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë rendin e gjymtyrëve në fjali dhe lidhjen e tij me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë; - të dallojë e të sqarojë dy llojet e rendeve të gjymtyrëve në fjali; - të përcaktojë rendin e secilës gjymtyrë në fjalinë dëftore. 	Rendi i gjymtyrëve në fjali Konceptet: gjymtyrëzimi aktual: tema, rema; rendi: i drejtë dhe i anasjellë, neutral dhe shprehës,	Veprimtaritë: Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë llojin e rendit të gjymtyrëve në fjali dhe lidhjen e tij me gjymtyrëzimin aktual. Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme për fjalinë në përgjithësi dhe llojet e saj sipas qëllimit të thënies. Organizohen ushtrime për të vënë në dukje renditjen e gjymtyrëve kryesore dhe të gjymtyrëve të dyta në fjalinë dëftore. Metodat: monolog – dialog; metoda e demonstrimit / metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës	Nxënësi mund: 4.3.1: të japë sqarime për rendin e gjymtyrëve në fjali dhe rëndësinë e tij; 4.3.2: të shpjegojë rendin e gjymtyrëve dhe lidhjen e tij me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë; 4.3.3: të bëjë dallimin midis rendit të drejtë e të anasjellë dhe rendit asnjës (neutral) dhe shprehës emocionues; 4.3.4: të përcaktojë rendin e secilës gjymtyrë në fjalinë dëftore dhe të flasë e të shkruajë duke iu përmbajtur rendit përkatës.
4.4	Nxënësi do të jetë i aftë:		Veprimtaritë:	Nxënësi mund:

	<ul style="list-style-type: none"> - të tregojë gjymtyrët e veçuara dhe shkaqet e veçimit të tyre; - të dallojë thirrurin në fjali e të sqarojë veçoritë e tij; - të përcaktojë fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme dhe grupet e tyre; - të tregojë fjalët e togjet e fjalëve të ndërshtëna dhe dallimin e tyre nga fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme. 	<p>Gjymtyrët e veçuara</p> <p>Thirrori</p> <p>Fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme</p> <p>Fjalët e togjet e fjalëve të ndërshtëna</p> <p>Konceptet: gjymtyrë të veçuara; thirrur; fjalë e togje fjalësh: të ndërmjetme, të ndërshtëna,</p>	<p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë gjymtyrët e veçuara, thirrurin dhe fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme përkatësisht të ndërshtëna.</p> <p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme për rendin e gjymtyrëve në fjali për t'u shpjeguar shkaqet e veçimit të gjymtyrëve.</p> <p>Organizohen ushtrime për të vënë në dukje veçoritë e thirrurit dhe për të shpjeguar fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme përkatësisht të ndërshtëna.</p> <p>Metodat: monolog – dialog; metoda e demonstrimit / metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	<p>4.4.1: të identifikojë gjymtyrët e veçuara dhe të shpjegojë shkaqet e veçimit të tyre;</p> <p>4.4.2: të përcaktojë thirrurin dhe veçoritë e tij;</p> <p>4.4.3: të tregojë fjalët e togjeve e fjalëve të ndërmjetme dhe llojet e tyre sipas kuptimit;</p> <p>4.4.4: të përcaktojë fjalët e togjet e fjalëve të ndërshtëna dhe të shpjegojë dallimin nga fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme.</p>
--	--	--	---	--

Emërtimi i njësisë modulare Letërsi				
Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të identifikojë kohën dhe rrethanat, në të cilat u paraqit realizmi si drejtim letrar, shkollë letrare ose formacion stilistikor; -të dallojë realizmin si metodë letrare (që ka karakter ahistorik) dhe si drejtim letrar (që ka karakter historik); -të dallojë fazat e zhvillimit të realizmit evropian dhe përfaqësuesit kryesor; -të dallojë karakteristikat e realizmit, duke i krahasuar me ato të dejttimeve letrare që i paraprijnë; -të identifikojë gjinitë letrare më të zhvilluara në letërsinë e realizmit; -të dallojë specificitetet e realizmit francez, anglez, amerikan dhe rus. 	<p>Realizmi në letërsinë evropiane, fazat e zhvillimit të tij dhe përfaqësuesit kryesorë</p> <p>Konceptet: realizmi si drejtim letrar, shkollë letrare apo formacion stilistikor; realizmi si metodë letrare, karakteristikat e realizmit.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nëpërmjet të leximit të fragmenteve nga një vepër romantike dhe një realiste, nxiten nxënësit të mendojnë rreth dallimeve mes tyre; - duke bërë përsëritje mbi kohën dhe rrethanat, që mundësuar lindjen e romantizmit në letërsi, shpjegohet koha dhe rrethanat që mundësuan lindjen e realizmit; - nxiten nxënësit të mendojnë për dallimin mes realizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar (shkollë letrare ose formacion stilistikot); - për t'i orientuar nxënësit, jepet shpjegimi se realizmi si metodë letrare, ashtu si edhe romantizmi, ka karakter ahistorik, pra elemente realiste gjejmë në të gjithë fazat e zhvillimit të letërsisë, kurse si drejtim letrar realizmi ka karakter historik dhe dominon në gjysmën e dytë të shek. XIX, pavarësisht se veprat e para realiste paraqiten që në vitet '30 të shek.XIX.; - nxiten nxënësit, në formë të përsëritjes, të përkujtohen në karakteristikat e romantizmit dhe duke folur për një karakteristike të caktuar të romantizmit, p.sh. qëndrimi ndaj realitetit, ndërtimi i personazheve, preokupimet tematike etj., shpjegohen po ato karakteristika të realizmit; 	<p>Nxënësi mund:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. të identifikojë kohën dhe rrethanat e dominimit të realizmit si drejtim letrar; 1.2. të bëjë dallim mes realizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar; 1.3. t'i memorojë karakteristikat kryesore të realizmit evropian; 1.4. të bëjë krahasim mes realizmin dhe romantizmin si drejtim letrar; 1.5. t'i dallojë dhe t'i emërtojë fazat e zhvillimit të realizmit evropian.

			<p>- duke u ndalë në emrat e përfaqësuesve me të njohur të realizmit evropian, shpjegohen fazat e zhvillimit të realizmit dhe karakteristikat e secilës fazë;</p> <p>-duke përmendur reprezentë të caktuar të letërsisë franceze, angleze, amerikane e ruse, mundohemi të shpjegojmë se, sikurse gjithë drejtimet tjera letrare, ashtu edhe realizmi, në mjedise të caktuara, karakterizohet me specificitete të veta;</p> <p>-jepen shpjegime rreth gjinive dhe llojeve letrare më të zhvilluara në letërsinë e realizmit evropian;</p> <p>Metodat: metoda e krahasimit; metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit.</p>	
2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të dallojë veçoritë kryesore të vep- rës së Dostojevskit;</p> <p>-të shpjegojë jetën dhe rrethanat jetësore të Dostojevskit;</p> <p>-t'i numërojë fazat e krijimtarisë letrare të Dostojevskit dhe veprat kryesore të secilës fazë;</p> <p>-të dallojë risitë që solli arti i Dosto- jevskit, nëpërmjet të analizës bërë romanit të tij "Krimi dhe</p>	<p>Fjodor Dostojevski - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: risitë që solli arti i Dostojevskit, ele- menti psikologjik në veprat e Dostojevskit, dija dhe nëndija e personazheve të Dostojevskit.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-duke përsëritur karakteristikat e realizmit rus dhe përfaqësuesit më të njohur të tij, ndalemi në informacionet kryesore mbi jetën dhe veprën e Dostojevskit;</p> <p>-pyeten nxënësit se cilat vepra të Dostojevskit i kanë të njohura dhe çfarë risish sjell arti i tij;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, gjegjësisht pyetjeve dhe përgjigjeve, jepen të dhëna për fazat e krijimtarisë letrare të Dostojevskit dhe për veprat më të njohura të secilës fazë;</p> <p>-lexohet fragmenti i dhënë në libër (nga romani "Krimi dhe ndëshkimi") dhe pyeten nxënësit se kush e ka lexuar</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>2.1. të identifikojë veprën e Dostojevskit;</p> <p>2.2. të dallojë veçoritë e artit të Dostojevskit;</p> <p>2.3. ta analizojë veprën "Krimi dhe ndëshkimi";</p> <p>2.4. ta analizojë Raskolnikovin si personazh;</p> <p>2.5. ta përcaktojë vendin e Dos- tojevskit në letërsinë botë-</p>

	ndëshkimi"; -të identifikojë elementin psikologjik të romaneve të Dostojevskit.		veprën dhe sa janë në gjendje ta analizojnë; -bashkë me nxënësit bëhet analiza e romanit dhe analiza e personazhit kryesor, Raskolnikovit; -duke analizuar personazhin kryesor të veprës, mundohemi t'i shpjegojmë elementet psikologjike të veprës letrare të Dostojevskit. Metodat: metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit.	rore.
3	Nxënësi do të jetë i aftë: - të identifikojë veçoritë e artit të Tolstoit; -të njohë rrethanat jetësore të Tolstoit; -të kuptojë rëndësinë e dy romaneve më të njohura të Tolstoit; -nëpërmjet të subjektit të romanit "Lufta dhe paqa" dhe "Ana Karenina", të identifikojë elementet realiste të veprës së Tolstoit; -të shpjegojë ngjarjet kryesore që trajtohen në dy romanet kryesore të Tolstoit;	Leon Nikolajevič Tolstoi-jeta dhe vepra Konceptet: realizmi rus, lufta ruso-franceze, ndërtimi i personazheve, shumësia e personazheve në romanin "Lufta dhe paqa".	Veprimtaritë: -në formë të përsëritjes, nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me karakteristikat dhe veçantitë e realizmit rus dhe përfaqësuesit kryesor të tij; -ndalemi në jetën dhe veprën e Tolstoit, duke dhënë informacion edhe për epokën, në të cilën jetoi dhe veprimi; -nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me veprat e Tolstoit për të cilat kanë dëgjuar, i kanë lexuar ose i kanë para si realizime filmike; -në formë të bashkëbisedimit, analizohet vepra "Lufta dhe paqa" dhe jepen gjykime për temën dhe idenë e veprës; -në formë të bashkëbisedimit, nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre për romanin "Ana Karenina" dhe personazhet kryesore të romanit, Anës dhe Vronskit;	Nxënësi mund: 3.1. ta kuptojë rolin dhe vendin që zë Tolstoi në letërsinë botërore; 3.2. të identifikojë stilin e veprave të Tolstoit; 3.4. të analizojë romanet kryesore të Tolstoit dhe të kuptojë vlerën e tyre; 3.5. t'i analizojë personazhet kryesore të romanit "Ana Karenina"; 3.6. të japë gjykime rreth personazheve kryesore të romanit "Ana Karenina" të Tolstoit.

	-të analizojë personazhet kryesore të dy veprave të Tolstoj; -të dallojë veçoritë kryesore të artit të Tolstoj;		-pasi të analizohet vepra dhe të lexohet e komentohet fragmenti i dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit që të prononcohen në lidhje me personazhet kryesore të romanit dhe vlerën e romanit; -nxiten nxënësit që të japin gjykime në lidhje me vendin që zë Tolstoj në letërsinë botërore. Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.	
--	--	--	---	--

		Emërtimi i njësive modulare Letërsi		
Nr.rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	Nxënësi do të jetë i aftë: -të dallojë nocionin “modern” (që nuk ka karakter historik) nga nocioni “modernia”, që shënon një koncept të caktuar artistik dhe ka karakter kohor; -të dallojë drejtimit e ndryshme që i përfshin në vete modernia si: parnasizmin, simbolizmin, ekspresionizmin, dadaizmin,	Modernia në letërsinë evropiane Konceptet: modern, modernia, parnasizmi, simbolizmi, impresionizmi, ekspresionizmi, dadaizmi, surrealizmi. . .	Veprimtaritë: -jepen shpjegime për dallimin mes nocionit “moder” (të qenit modern, bashkëkohor) dhe “modernia” që shënon një periudhë letrare, që karakterizohet me pluralizëm stilistikor dhe në vete përfshin më shumë drejtime, si: parnasizmin, simbolizmin, impresionizmin, ekspresionizmin, dadaizmin, surrealizmin. . . ; -pyeten nxënësit a kanë lexuar veprat e ndonjë përfaqësuesi të madh të modernies dhe a janë në gjendje t’i kuptojnë risitë që sjellin drejtimit e ndryshme të modernies;	Nxënësi mund: 1.1. të bëjë dallim mes nocionit “modern” dhe “modernia”; 1.2. të identifikojë drejtime të ndryshme letrare brenda modernies; 1.3. ta kuptojë lidhjet e letërsisë së simbolizmit me muzikën dhe asaj të parnasizmit me artin figurativ;

	<p>surrealizmin. . . ;</p> <p>-të dallojë veprat e modernies prej veprave të romantizmit apo realizmit;</p> <p>-ta kuptojë rolin që luan intuita në letërsinë e kësaj periudhe;</p> <p>-të numërojnë dhe emërtojnë përfaqësuesit kryesor të modernies, si: G. Apolinerin, P. Verlenin, P. Valery-në, A. Rembonë, T. Eliotin, Xh. Xhojsin, M. Prustin, F. Kafkën, etj.</p>		<p>-jepet shpjegimi se krijuesit e kësaj letërsie nuk imitojnë natyrën, por mundohen të krijojnë forma të reja, të panjohura deri atëherë dhe të befasojnë. Modernia i kushton kujdes të veçantë intuitës së njeriut;</p> <p>- nga drejtimet e modernies më tepër fokusohemi në simbolizmin dhe përfaqësuesit kryesor të simbolizmit dhe në raportin që vendos simbolizmi me artet tjera, sidomos me muzikën.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>1.4. t'i emërtojë përfaqësuesit kryesor të modernies dhe kryeveprat e tyre.</p>
2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të përcaktojë vendin e E. A. Po-es në letërsinë botërore;</p> <p>-të njohë Po-en si një nga themeluesit e letërsisë kriminalistike dhe horror;</p> <p>-të njihet me kontributin e Po-es në të tri gjinitë letrare, në publicistikë dhe në kritikën letrare;</p> <p>-të identifikojë veçantitë stilistikore të artit të E. A. Po-es;</p> <p>-nëpërmjet të shembullit të Po-es, të bëjë dallim mes jetës së autorit</p>	<p>Edgar Alan Po- jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: letërsia kriminalistike, letërsia horror, zhanret letrare (poezia, proza, drama), shkrimet kritike dhe publicistike, paralajmërtari i simbolizmit.</p>	<p>- Veprimtaritë:</p> <p>-do të diskutohet me nxënësit për raportin që kanë me filmat kriminalistike apo horror, për t'u ndalë në kontributin që ka dhënë E. A. Po në zhvillimi e zhanreve të tilla në letërsi;</p> <p>-nxënësit njihen me jetën dhe veprën e E. A. Po-es dhe me faktin se Po-e ishte autor, arti i të cilit i paraprinte kohës. Atë e zbuloi dhe e afirmoi Bodleri, duke e konsideruar si pararendës të simbolizmit;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxënësit motivohen të mendojnë se vepra e autorit nuk duhet identifikuar me jetën e tij – Po-e është një shembull për të shpjeguar këtë gjë;</p> <p>-nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet që secili grup ta lexojë poemën “Korbi” dhe ta analizojë. Do të</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>2.1. të identifikojë veprën e E. A. Po-së dhe vendin që zë ajo në letërsinë botërore;</p> <p>2.2. t'i numërojë zhanret dhe llojet letrare që i trajtoi E. A. Po;</p> <p>2.3. të analizojë poemën “Korbi” të E. A. Po-së;</p> <p>2.4. të krahasojë përkthimin shqip të bërë nga Noli me origjinalin në anglisht;</p> <p>2.5. të shkruajë një ese për poemën “Korbi”.</p>

	<p>dhe veprës së tij;</p> <p>-të analizojë “Korbin” dhe të japë vlerësimet e tij për këtë kryevepër të E. A. Po-es dhe të letërsisë botërore;</p> <p>-të ndalet në vlerat artistike të poemës “Korbi”;</p> <p>-të shijojë bukurinë e përkthimit shqip të poemës “Korbi” bërë nga Fan S. Noli.</p>		<p>kërkohet analizë edhe e formës edhe e përmbajtjes dhe nxënësve do t’ju jepet shpjegimi se Noli, gjatë përkthimit shqip të kësaj poeme, ka ndryshuar gjatësinë e vargut dhe numrin e vargjeve, pra ka prekur formën e saj;</p> <p>-“Korbi” krahasohet me poemën “Vaje” të Çajupit, që nxënësit e kanë të njohur nga viti i kaluar;</p> <p>-pasi të analizohet poema, e cila është tërheqëse, kërkohet që nxënësit të shkruajnë një ese, në të cilën do t’i shprehin mendimet e veta mbi këtë poemë;</p> <p>-shkrimet më të bukura lexohen në klasë.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	
3	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-ta kuptojë rolin që luan dhe kthesën që bën vepra e Bodlerit në letërsinë evropiane;</p> <p>-të identifikojë elementet simboliste në veprën e Bodlerit;</p> <p>-të njoh rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Bodlerit dhe raportin që vendosi ajo me realitetin;</p> <p>-të analizojë poezitë më të njohura nga përmbledhja “Lulet e së keqes”,</p>	<p>Sharl Bodleri – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: proza, poezia, përkthimet, kalimi nga romantizmi drejt simbolizmit, fetishizimi i fjalës, raporti me muzikën, muzikalitetin, e bukura dhe e shëmtuara si</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-meqë tema u është paralajmëruar paraprakisht nxënësve, pritët që ata të kenë lexuar diçka nga Sh. Bodleri dhe të kenë një përshtypje të përgjithshme për risitë që sjell arti i tij;</p> <p>-nxiten nxënësit që t’i shprehin mendimet e tyre rreth asaj se sa e kanë kuptuar dhe sa ju ka pëlqyer përmbledhja poetike “Lulet e së keqes”;</p> <p>-nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë ta analizojë një poezi të Bodlerit dhe kërkohet që çdo grup, nëpërmjet të një përfaqësuesi të zgjedhur, të bëjë analizë të një poezie të caktuar;</p> <p>-pasi çdo grup bën analizën e poezisë së dhënë, hapet</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>3.1. të dallojë veçoritë e artit bodlerian;</p> <p>3.2. ta kuptojë rolin që luan vepra e Bodlerit, e cila paraqet një kthesë në artin evropian;</p> <p>3.3. të numërojë poezitë më të njohura nga përmbledhja “Lulet e së keqes” të Bodlerit;</p> <p>3.4. ta analizojë poezinë “Albatrosi” dhe ta deshifrojë simbolikën e saj.</p>

	si poezinë “Albatrosi”, “Himn i bukurisë”, “Evgjitët n`udhëtim”, “Kufoma” etj.; -të analizojë simbolikën e poezisë “Albatrosi”.	kategori estetike.	diskutim dhe nxiten nxënësit të mendojnë dhe të shprehen në lidhje me veçantitë dhe risitë e artit bodlerian; -bashkë me nxënësit lexohet dhe analizohet poezia “Albatrosi” dhe diskutohet rreth simbolikës së saj; - nxënësve ju jepet si detyrë shtëpie që, sipas dëshirës, të analizojnë një poezi nga përmbledhja “Lulet e së keqes”; -punimet më të mira lexohen dhe komentohen në klasë. Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.	
--	--	--------------------	---	--

Emërtimi i njësive modulare Letërsi				
Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptete	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	Nxënësi do të jetë i aftë: -të njihet me rrethanat, të cilat mundësuan paraqitjen e pluralizmit stilistikor, me të cilin karakterizohet leterësia shqipe e kësaj periudhe (elementet e realizmit, elementet e neoklasizmit, elementet e	Letërsia shipe mes dy luftërave botërore Pluralizmi stilistikor i letërsisë shqipe të periudhës mes dy luftërave botërore	Veprimtaritë: -nxiten nxënësit që, në formë të përsëritjes, të kujtojnë kohën, rrethanat dhe karakteristikat kryesore të realizmit në letërsinë shqipe dhe përfaqësuesit e parë të saj; -nxiten nxënësit të mendojnë rreth autorëve tjerë, që i takojnë periudhës mes dy luftërave botërore dhe veprat	Nxënësi mund: 1.1. të identifikojë pluralizmin stilistikor në letërsinë shqipe të kësaj periudhe; 1.2. ta kuptojë karakterin e vonuar të letërsisë shqipe; 1.3. të dallojë elementet realiste, neokla-

	<p>modernies);</p> <p>-të dallojë specificitetet e letërsisë shqipe mes dy luftërave botërore dhe përfaqësuesit kryesor të saj;</p> <p>-t'i dallojë dhe identifikojë elementet e drejtimeve të ndryshme letrare në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-t'i emërtojë përfaqësuesit kryesor të kësaj letërsie dhe t'i memorojë veprat më të rëndësishme të tyre;</p> <p>-t'i numërojë dhe shpjegojë gjinitë dhe llojet letrare më të zhvilluara në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-të vërejë raportet e intensifikuara të letërsisë shqipe të kësaj periudhe me letërsitë e mëdha evropiane.</p>	<p>Konceptet: neoklasicismi, realizmi kritik, letërsia moderne (simbolizmi, parnasismi, ekspresionizmi. . .) format letrare.</p>	<p>që mund t'i kenë lexuar;</p> <p>-shpjegohet pluralizmi stilistik i letërsisë shqipe të kësaj periudhe dhe raporti i saj me letërsitë më të njohura evropiane;</p> <p>-përmenden përfaqësuesit kryesor të letërsisë shqipe të kësaj periudhe dhe veprat e tyre më të njohura;</p> <p>-nxiten nxënësit të mendojnë rreth gjinive më të lëvruara letrare dhe veprave më të njohura ngë secila gjini.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>siciste dhe moderne të letërsisë së kësaj periudhe;</p> <p>1.4. t'i emërtojë përfaqësuesit kryesor të letërsisë shqipe mes dy luftërave botërore;;</p> <p>1.5. t'i numërojë dhe identifikojë gjinitë dhe llojet letrare më të njohura të kësaj periudhe;</p> <p>1.6. t'i memorojë veprat më të njohura të kësaj periudhe.</p>
2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-ta përshkruajë rrugën jetësore të Gjergj Fishtës dhe kontributin e tij në jetën politike, fetare, kulturore dhe letrare;</p> <p>-të memorojë veprat kryesore të gjinive të ndryshme letrare të Gj. Fishtës;</p> <p>-ta shpjegojë problematikën kombëtare shqiptare në "Lahutën e Malcis";</p>	<p>Gjergj Fishta – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: epika, lirika, dramatika, raporti me letërsinë gojore, Lahuta e Malcis, Mrizi i zanave, Anzat e Parnasit, Vallja</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepin informacione për rrugën jetësore të Fishtës dhe veprat e tij kryesore;</p> <p>-pyeten nxënësit se cilat janë veprat më të njohura epike, lirike e dramatike të Fishtës;</p> <p>-më ndihmën e nxënësve, analizohet "Lahuta e Malcis";</p> <p>-pasi shpjegohet subjekti i veprës, diskutohet rreth raportit të veprës me historinë dhe me letërsinë gojore;</p> <p>-analizohen personazhet kryesore të Lahutës, si: Oso Kuka, Ali Pashë Gucia, Marash Uçi, Patër Gjoni, Tringa, Dedë Gjo Luli. . .</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>2. 1.ta përcaktojë vendin e Fishtës në letërsinë tonë kombëtare;</p> <p>2.2. t'i numërojë veprat më të njohura letrare të Fishtës;</p> <p>2.3. ta analizojë "Lahutën e Malcis" të Fishtës;</p> <p>2.4. t'i numërojë personazhet kryesore të kryeveprës së Fishtës;</p> <p>2.5. t'i numërojë dhe emërtojë veprat më të njohura lirike, satirike e dramatike të</p>

	<p>-t`i numërojë preokupimet tematike të poezisë lirike të Fishtës;</p> <p>-t`i dallojë vlerat letrare dhe tematikën e satirës së Fishtës;</p> <p>-t`i numërojë dramat më të njohura të Gj. Fishtës;</p> <p>-të përcaktojë vendin që zë Fishta në letërsinë shqipe, në përgjithësi.</p>	<p>e Parrizit, Gomari i Babatasit, Juda Makabe, Jerina ose Mbretëresha e luleve, Hylli i Dritës.</p>	<p>- diskutohet rreth preokupimeve tematike të lirikës patriotike të Fishtës;</p> <p>-jepen informacione për satirën shoqërore e politike të Fishtës dhe veçmas për “Gomarin e Babatasit”;</p> <p>-përmendet kontributi i Fishtës në fushën e dramës dhe dramat kryesore të Fishtës;</p> <p>-në formë të rezimesë, kërkohet nga nxënësit që t`i shprehin mendimet e tyre rreth vendit të Fishtës në jetën shoqërore, kulturore dhe letrare të kësaj periudhe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>Fishtës;</p>
3	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të kuptojë vendin që zë Kristo Floqi në letërsinë shqipe;</p> <p>-të fitojë njohuri mbi jetën dhe veprën e K. Floqit;</p> <p>-nëpërmjet të komedive të Floqit, të njihet me rrugën zhvillimore të llojit të komedisë në letërsinë shqipe mes dy luftërave botërore;</p> <p>-të identifikojë preokupimet tematike të komedive të K. Floqit;</p> <p>-ta shpegojë dhe analizojë komedinë “Vëllazëri e interes”;</p>	<p>Kristo Floqi - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: gjinitë letrare, llojet letrare, preokupimet tematike, Vëllazëri e interes, Burri – burrë, Akrahallëku, Zi e më Zi, E mbesa e krahinarit, personazhet, të metat e komedive.</p>	<p>Veprimtaritë</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Kristo Floqit;</p> <p>-shpjegohet kontributi i Floqit si komediograf dhe boshllëku që komeditë e tij plotësojnë në gjininë e dramës, gjegjësisht në llojin e komedisë;</p> <p>-lexohet fragmenti i dhënë nga komedia “Vëllazëri e interes” dhe nxiten nxënësit që të mendojnë rreth temës së komedisë;</p> <p>-jepen shpjegime shtesë mbi këtë komedi dhe kërkohet nga nxënësit që të analizojnë personazhet e komedisë: Mitin, Kocin, Margën dhe Olimpinë;</p> <p>-jepen informacione për temat e komedive tjera të</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>3.1. të fitojë pasqyrë të përgjithshme mbi vendin e Kristo Floqit në letërsinë shqipe;</p> <p>3.2. t`i përmend komeditë e botuara të Kristo Floqit;</p> <p>3.3. t`i numërojë preokupimet tematike të komedive të Floqit;</p> <p>3.4. të analizojë komedinë “Vëllazëri e interes”;</p> <p>3.5. të analizojë personazhet kryesore të kësaj komedie;</p> <p>3.6. të dallojë pikat e dobëta të komedive të Kristo Floqit.</p>

	<p>-t`i numërojë dhe emërtojë komeditë tjera të botuara të Floqit;</p> <p>-t`i përmend preokupimet tematike të komedive të K. Floqit;</p> <p>-ta shpjegojë boshllëkun që mbushin komeditë e K. Floqit në letrat shqipe.</p>		<p>Kristo Floqit;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre mbi Floqin si komediograf dhe vendit që zë ai në letërsinë shqipe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst;</p>	
4	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-t`i identifikojë rrethanat, në të cilat u paraqit dhe u krijua figura poliedrike e Faik Konicës;</p> <p>-të njohë jetën dhe veprën e Konicës;</p> <p>-të numërojë kontributin e Konicës në më shumë sfera të dijes, si në: diplomaci, publicistikë, gjuhësi, veprimtari përkthyes, kritikë letrare dhe letërsi, veçmas në fushën e prozës;</p> <p>-të memorojë llojet e prozës që lëvroi Konica dhe risitë që solli në fushën e prozës;</p> <p>-të identifikojë elementin modern të prozës së Konicës;</p> <p>-të analizojë "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurasit" dhe personazhin kryesor të saj;</p> <p>-të njohë kontributin e Konicës në fu-</p>	<p>Faik Konica - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: publicistika, gjuhësia, diplomacia, poezia, proza poetike, proza portret, skica, eseistika, tregimi, romani, kritika letrare, përkthimi letrar, polemikat, qëndrimi kritik ndaj veseve shqiptare, ambasador i kulturës dhe traditave shqiptare, Vatra.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për jetën dhe veprën e Faik Konicës, duke u ndalë në veprimtarinë e tij në kryqendrat botërore, si në Paris, Bruksel, Londër e Uashington;</p> <p>-njohtohen nxënësit me kulturën enciklopedike të Konicës;</p> <p>-jepen informacione për rolin që luan "Albania" e Konicës;</p> <p>-bashkë me nxënësit analizohet "Doktor Gjilpëra. . ." dhe personazhi kryesor i veprës;</p> <p>-komentohet lloji letrar i veprës dhe mendimet e kritikës rreth kësaj çështje;</p> <p>-ndalemi në gjuhën e kësaj vepre të Konicës dhe jepen informacione për kontributin e Konicës në fushën e gjuhës në përgjithësi dhe të gjuhës së veprës letrare, në veçanti;</p> <p>-jepet informacion për veprat tjera të Konicës, për Konicën si poet, për kontributin e tij në lëvrimin e</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>4.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin e Konicës në kulturën dhe letërsinë shqipe</p> <p>4.2. të numërojë dhe memorojë kontributin e Konicës në më tepër fusha të dijes, si në publicistikë, gjuhësi, veprimtari përkthyes dhe mbi të gjitha, në letërsi, veçmas në prozë;</p> <p>4.3. të numërojë dhe emërtojë llojet e prozës që i lëvroi Konica dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin e prozës shqiptare;</p> <p>4.4. ta analizojë "Doktor Gjilpëren. ." e Konicës dhe personazhin kryesor të saj;</p> <p>4.5. të memorojë titujt e veprave tjera të Konicës;</p> <p>4.6. të shkruaj një ese për një vepër të Konicës, sipas zgjedhjes së tij.</p>

	<p>shën e eseistikës;</p> <p>-t'i kuptojë vlerat dhe porositë e veprave tjera të rëndësishme të Konicës ("Katër përralla nga Zullullandi", "Shqipëria si m'u duk", "Shqipëria, kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore");</p> <p>-të përcaktojë vendin e Konicës në letërsinë shqipe dhe roli e tij në afirmimin e letërsisë, kulturës, traditës, folkorit dhe qenies shqiptare në qarqet botërore.</p>		<p>llojeve të caktuara të prozës, si: prozës poetike, prozës portet, skicës, eseut, tregimit dhe nëse koha na lejon, secili lloj prozaik shpjegohet me një shembull konkret (p.sh proza poetike me "Anës liqenit"; proza portret me "Fan Noli", eseja me "Lutja e shkrimtarit", "Jeta dhe librat" etj.);</p> <p>-nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një ese për ta lexuar dhe komentuar;</p> <p>-dëgjohen komentet e secilit grup dhe jepen shpjegime shtesë, sipas nevojës;</p> <p>-kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një ese, ku do të analizojnë një vepër të Konicës (sipas zgjedhjes së tyre).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	
5	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të përshkruajë vendin e Fan Nolit në kulturën dhe letërsinë shqipe;</p> <p>-të njohë rrethanat shoqërore shqiptare të kohës dhe kontributin e Fan Nolit në to;</p> <p>-të njohë kontributin e Nolit në më shumë sfera të dijes, si: në jetën politike, në publicistikë, në histori, në muzikologji, në fushën e përkthimeve</p>	<p>Fan S. Noli – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Albumi, Izraelitë dhe filistinë, Histori e Skënderbeut, Bethoveni dhe revolucioni borgjezo-francez, Vatra, Dielli, burrë shteti, përk-</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njihen me të dhënat jetësore mbi Fan Nolin dhe kontributin e tij në më shumë sfera të dijes, si: në jetën politike e fetare, në jetën kulturore, shkencore, publicistike, në jetën letrare (në fushën e poezisë dhe dramës) dhe në fushën e përkthimeve letrare e kritikës letrare.</p> <p>-bashkë me nxënësit lexohen dhe analizohen poezitë e përmbledhjes "Albumi", duke u ndalë më shumë në poezitë me motiv biblik dhe në poezitë "Anës lumenjve"</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>5.1. të shpjegojë vendin e Nolit në kulturën shqiptare;</p> <p>5.2. t'i memorojë poezitë më të njohura të Nolit;</p> <p>5.3. t'i analizojë poezitë "Anës lumenjve" dhe "Rent, or Marathonomak";</p> <p>5.4. t'i numërojë dhe shpjegojë simbolet e poezisë me motiv biblik;</p> <p>5.5. t'i numërojë dhe emërtojë veprat</p>

	<p>letrare, në kritikën letrare, në autoqefalinë e kishës orthodoxe shqiptare dhe veçmas në letërsi;</p> <p>-të analizojë poezitë e përmbledhjes “Albumi”, veçmas poezitë patriotiko-politike të Noli, sidomos poezitë me motiv biblik;</p> <p>-ta kuptojë simbolikën e poezive të Nolit, sidomos të poezive me motiv biblik;</p> <p>-ta njohë veprën dramatike të Nolit dhe raportin e saj me Biblën;</p> <p>-të memorojë përkthimet më të rëndësishme letrare të Nolit;</p> <p>-ta kuptojë kontributin e Nolit në fushën e kritikës letrare;</p> <p>-ta njohë kontributin e Nolit në fushën e studimeve historike dhe muzikologjike (“Historinë e Skënderbeut” dhe “Bethoveni dhe revolucioni borgjezo-francez”).</p>	<p>thimet letrare, introduktat, publicistika, raporti me Biblën.</p>	<p>dhe “Rent, or Marathonomak”;</p> <p>-jepen informacione për Nolin si përkthyes (mund të ndalemi te një fragment nga përkthimi i “Korbit” të Edgar Allan Po-es);</p> <p>-jepen informacione për Nolin si kritik letrar dhe rolin e “Introduktave” të tij;</p> <p>-jepen informacione për Nolin si studiues, duke u ndalë në vlerën shkencore të veprës së tij “Historia e Skënderbeut” dhe “Bethoveni dhe revolucioni borgjezo-francez”;</p> <p>- nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup përzgjedh një poezi dhe e analizon;</p> <p>-kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një ese për Nolin (janë të lirë që vetë të zgjedhin se për cilin aspekt të veprës së Nolit do të shkruajnë).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>tjera të Nolit, si veprën dramatike, veprën historike dhe muzikologjike;</p> <p>5.6.ta përshkruajë kontributin e Nolit në fushën e përkthimeve letrare dhe t’i përmend përkthimet më të njohura të tij;</p> <p>5.7. ta përshkruajë kontributin e Nolit në kritikën letrare;</p> <p>5.8.ta përshkruajë kontributin e Nolit në publicistikën shqiptare ;</p> <p>5.9.të shkruajë një ese për Nolin.</p>
6	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të përshkruajë vendin e Ali Asllanit në letërsinë shqipe;</p> <p>-t’i numërojë motivet dhe temat kryesore të poezive të Ali Asllanit;</p> <p>-t’i memorojë poezinë më të njohura</p>	<p>Ali Asllani –jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Hanko Halla, Hakërrim, motivi</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e Ali Asllanit;</p> <p>-lexohen poezi të motiveve të ndryshme (motivit patriotik, erotik dhe shoqëror) dhe nxiten nxënësit të mendojnë rreth preokupimeve kryesore tematike të</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>6.1. të identifikojë veprën e Ali Asllanit;</p> <p>6.2.të njohë kontributin e Ali Asllanit në letërsinë shqipe dhe ndikimin që pati poezia e tij te poetët më të rinj;</p>

	<p>të Ali Asllanit me motiv shoqëror;</p> <p>-ta shpjegojë dhe analizojë poemën “Hanko Halla” dhe “Hakërrim”;</p> <p>-t`i identifikojë veçantitë e poezisë së Ali Asllanit, karakteristikat e saj gjuhësore dhe metrike.</p>	<p>patriotik, motivi shoqëror, motivi erotik, humori dhe satira, zë i veçantë në letërsinë shqipe të viteve `20-30; ndikimi që pati te poetët që i pasvijne.</p>	<p>poezisë së Ali Asllanit;</p> <p>-lexohen fragmente nga poezia “Hakërrim”, e cila analizohet dhe kërkohet nga nxënësit që të mendojnë se cilat kategori të njerëzve i demaskon autori në këtë poezi;</p> <p>-lexohen fragmente nga poema “Hanko Halla” dhe nxiten nxënësit që ta shpjegojnë dhe analizojnë këtë poemë, duke përfshirë përmbajtjen dhe formën;</p> <p>-nxiten nxënësit të diskutojnë rreth mënyrës si trajtohet tema e konfliktit mes gjeneratave në poemën e A. Asllanit;</p> <p>-duke u nisë nga fragmentet e lexuara, nxiten nxënësit të mendojnë rreth karakteristikave gjuhësore të poemës.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>6.3.ta njohë raportin e poezisë së Ali Asllanit me folklorin shqiptar;</p> <p>6.4.të njohë veçantitë gjuhësore të veprës së Ali Asllanit;</p> <p>6.5.t`i numërojë e memorojë tituj e poezive më të njohura patriotike, erotike e shoqërore te Ali Asllanit;</p> <p>6.6.ta shpjegojë e analizojë poemën “Hanko Halla” të Ali Asllanit.</p>
7	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të njohë vendin e Lasgush Poradecit në letërsinë shqipe;</p> <p>-të identifikojë elementet moderne të poezisë lasgushiane;</p> <p>-t`i numërojë preokupimet tematike të poezisë së L. Poradecit;</p> <p>-të memorojë poezitë më të njohura nga secili motiv;</p> <p>-ta veçojë qëndrimin lasgushian ndaj</p>	<p>Lasgush Poradeci – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: poezi moderne, elementet romantike,qëndrimi ndaj fjalës dhe muzikalitetit, poezia erotike, poezia deskriptive,</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për jetën dhe veprën e Lasgush Poradecit;</p> <p>-lexohen vargjet e para të poezisë “Zog` i qiejve” dhe shpjegohet përpjekja e Lasgushit që të sjell tone të reja në poezinë shqipe;</p> <p>-lexohet poezia “Vallja e yjeve” dhe jepen shpjegime për poezinë erotike të Lasgush Poradecit që ka shtrirje shumë të gjërë;</p> <p>-jepen shpjegime për përkufizimin që jep L. Poradeci për</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>7.1. ta përcaktojë vendin që zë Lagushi në letërsinë shqipe;</p> <p>7.2. të përmend elementet moderne të poezisë së Lasgush Poradecit;</p> <p>7.3. t`i numërojë dhe emërtojë motivet dhe temat kryesore të poezisë së Lasgush Poradecit;</p> <p>7.4. t`i memorojë titujt e poezive më të njohura të Lasgushit;</p>

	<p>gjuhës poetike dhe muzikalitetin e poezisë së tij;</p> <p>-t`i analizojë poezitë e triptikut të vdekjes , në veçanti kryeveprën e tij poetike “Vdekja e Nositit”;</p> <p>-ta shpjegojë qëndrimin që mbron Lasgushi në poezitë e tij erotike dhe preokupimet tematike të poezisë erotike;</p> <p>-t`i dallojë poezitë më të njohura përshkruese të L. Poradecit dhe ta analizojë poezinë “Poradeci”;</p> <p>-të identifikojë risitë që sjell poezia lasgushiane në rrugën zhvillimore të poezisë shqipe.</p>	<p>poezia patriotike, poezia filozofike.</p>	<p>dashurinë dhe për temat që i gjejmë brenda poezisë erotike;</p> <p>-lexohet poezia “Poradeci” dhe nxiten nxënësit që të gjejnë elementet përshkruese, patriotike dhe filozofike të kësaj poezie, ndër më të veçantat e letërsisë sonë;</p> <p>-lexohen poezitë e triptikut të vdekjes –”Lundra dhe flamuri”, “Gjeniu i anijës” dhe “Vdekja e Nositit”(analizohet dhe shpjegohet simbolika e tyre).</p> <p>-nxiten nxënësit të shkruajnë një ese për poezinë e L. Poradecit në përgjithësi ose për një poezi të caktuar të tij.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e komunikimit ; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>7.5. ta analizojë poezinë “Vdekja e Nositit”;</p> <p>7.6. të shpjegojë qëndrimin e Lasgushit ndaj formës poetike.</p>
8	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-t`i njohë rrethanat e kohës, në të cilën u krijua vepra letrare e Mitrush Kutelit;</p> <p>-të identifikojë raportin e veprës së Kutelit me folklorin shqiptar dhe me filozofinë fetare;</p> <p>-të shpjegojë llojet e prozave që trajtoi Kuteli dhe kontributin e tyre, sidomos të tregimit;</p> <p>-të numërojë dhe emërtojë preokupimet tematike të tregimeve të Kutelit;</p>	<p>Mitrush Kuteli – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: proza e shkurtër, proza e gjatë, rrëfimet, rrëfenjëzat, raporti me folklorin, raporti me filozofinë e krishterë, Vjeshta e Xheladin beut, E madhe është gjëma e mëkatit, Si e gjeti Ago</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për rrugën jetësore dhe për veprimtarinë letrare të Mitrush Kutelit;</p> <p>-në pika të shkurta informohen nxënësit me preokupimet tematike të poezisë së Kutelit;</p> <p>-jepen informacione për llojet e prozave që i trajtoi Kuteli, duke u ndalë veçmas te tregimet dhe preokupimet tematike të tyre;</p> <p>-lexohet fragmenti i dhënë nga “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”;</p> <p>-nxiten nxënësit të mendojnë rreth mesazhit që jep autori në këtë vepër dhe diskutohet për ndikimin nga filozofia fetare;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>8.1. ta vlerësojë kontributin e Kutelit në zhvillimin e letërsisë shqipe, veçmas të prozës;</p> <p>8.2. të shpjegojë preokupimet tematike të prozës së Kutelit;</p> <p>8.3. të identifikojë veçoritë gjuhësore e stilistike të prozës së Kutelit;</p> <p>8.4. të shpjegojë “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”;</p> <p>8.5. të analizojë “Vjeshtën e Xheladin beut”</p> <p>8.6. të identifikojë raportin e prozës së</p>

	<p>-të analizojë “Vjeshtën e Xheladin beut” dhe “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”;</p> <p>-të njohë përpjekjen e Kutelit për të trajtuar prozën e gjatë (novelën dhe romanin);</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme për Kutelin si përkthyes dhe kritik letrar;</p> <p>-të dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të prozës së Kutelit dhe vendin e saj në letërsinë shqipe.</p>	<p>Jakupi rrugën e Zotit, Rinë Katerinëza, Xha Brahua i Skëmbanores, poezia e Kutelit, proza e gjatë –novela, romani (“Në një cep të lllirisë së poshtme”).</p>	<p>-shpjegohet subjekti i novelës “Vjeshta e Xheladin beut” dhe nxiten nxënësit të bëjnë analizë psikologjike të personazhit kryesor të novelës;</p> <p>- nxiten nxënësit që, duke u mbështetur në fragmentin e dhënë, të diskutojnë rreth gjuhës dhe stilit të prozës së Kutelit.</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për Kutelin si poet dhe si autor të prozës së gjatë (novelës dhe romanit);</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për kontributin e Kutelit si përkthyes letrar dhe si kritik letrar.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e demonstrimit, metoda e komunikimit, metoda analitike, metoda e krahasimit.</p>	<p>Kutelit me folklorin shqiptar.</p>
9	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të njohë rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Migjenit;</p> <p>-të dallojë elementet novatore të veprës së Migjenit;</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme mbi preokupimet tematike të prozës së Migjenit;</p> <p>-të dallojë klasifikimet e prozës së Migjenit sipas formës dhe sipas përmbajtjes;</p> <p>-të analizojë realizimet më të njohura</p>	<p>Millosh Gjergj Nikolla –Migjeni –jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Novelat e qytetit të veriut, Vargjet e lira, Parathënia e parathënieve, Këngët e ringjalljes, Këngët e mjerimit, Këngët e perëndimit, Këngë në vetë,</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-pyeten nxënësit se cilat vepra të Migjenit i njohin;</p> <p>-jepen informacione mbi jetën dhe veprën e Migjenit dhe vendin që zë Migjeni në letërsinë shqipe;</p> <p>-ndalemi të llojet e ndryshme të prozave të Migjenit, sipas formës dhe përmbajtjes dhe përmenden prozat më të njohura të secilit lloj;</p> <p>-lexohet “Legjenda e misrit” dhe kërkohet nga nxënësit që të shprehin mendimet e veta në lidhje me këtë veprë;</p> <p>-nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë që të lexojë një nga prozat e njohura të Migjenit (“Bukuria që vret”, “Historia e njëres nga ata”, “Studenti</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>9.1. të formojë një opinion të përgjithshëm mbi veprën e Migjenit dhe vendin që zë ajo në letërsinë shqipe;</p> <p>9.2. të identifikojë qëndrimin kritik të Migjenit ndaj shoqërisë shqiptare të kohës;</p> <p>9.3. të njohë preokupimet tematike të veprës së Migjenit;</p> <p>9.4. të vlerësojë risitë që sjell vepra e Migjenit në përmbajtje dhe në formë;</p> <p>9.5. të numërojë dhe shpjegojë shkrimet më të njohura prozaike të Migjenit;</p>


	<p>prozaïke të Migjenit nga “Novelat e qytetit të veriut”;</p> <p>-ta vlerësojë përmbledhjen poetikë “Vargjet e lira”;</p> <p>-t’i emërtojë ciklet poetike nga përmbledhja “Vargjet e lira”, duke u ndalë në preokupimet tematike të secilit cikël;</p> <p>-t’i memorojë poezitë më të njohura të Migjenit;</p> <p>-të analizojë “Poemën e mjerimit”;</p> <p>-të numërojë personazhet më të njohura të veprës së Migjenit (edhe të poezisë edhe të prozës) si: lypësin, malësorin, punëtorin e papunë, femrën që shet moralin, malësoren, nënën që mallkon fëmijën e saj etj.;</p> <p>-të kuptojë risitë që sjell vepra e Migjenit në përmbajtje dhe në formë.</p>	<p>Këngët e rinisë, Këngët e fundit; skica, tregimi, novela, proza me motiv nga jeta e qytetit, proza me motiv nga jeta e fshatit.</p>	<p>në shtëpi”, Qershijat”, “Në kishë”, “Sokrat e vyejtun apo derr i kënaqur”, “Bukën tonë të përditshme falna sot”, “Moll e ndalueme”) dhe kërkohet që një reprezent i grupit t’i prezentojë mendimet e grupit para klasës. Kështu fitohet një pasyrë më e qartë për më shumë shkrime prozaïke të Migjenit;</p> <p>-jepën informacione mbi përmbledhjen poetike “Vargjet e lira” të Migjenit;</p> <p>-analizohen ciklet poetike të përmbledhjes “Vargjet e lira” dhe nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre mbi poezitë më të njohura nga secili cikël;</p> <p>-analizohet me kujdes cikli “Këngët e mjerimit” dhe veçmas “Poema e mjerimit” si kryevepër e Migjenit;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehin opinionet e tyre mbi vendin e Migjenit në letërsinë tonë kombëtare;</p> <p>-analizohen personazhet kryesore të veprës së Migjenit;</p> <p>-analizohet gjuha dhe metrika e poezisë migjeniane.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e komunikimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>9.6. t’i numërojë dhe emërtojë ciklet poetike të përmbledhjes “Vargjet e lira”;</p> <p>9.7. ta analizojë “Poemën e mjerimit”;</p> <p>9.8. t’i njohë karakteristikat gjuhësore dhe risitë që sjell vargu migjenian.</p>
10	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të njohë rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Sterjo Spasses;</p> <p>-të dallojë veçantitë e veprës së Sterjo Spasses;</p> <p>-të analizojë romanin “Pse” dhe rolin</p>	<p>Sterjo Spasse – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Pse, romani i mohimit, Gjon Zaveri, Afërdita,</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njohtohen me jetën e Sterjo Spasses dhe veprimtarinë e tij letrare;</p> <p>-nxiten nxënësit që t’i shprehin mendimet e veta rreth romanit “Pse” dhe rolin që luan ai në letërsinë shqipe të kohës;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>10.1. të fitojë një pasqyrë mbi jetën dhe veprën e Sterjo Spasses;</p> <p>10.2. ta shpjegojë subjektin e romanit “Pse” dhe ta analizojë personazhin kryesor;</p>

	<p>që luan ai në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-të analizojë romanin “Afërdita” ;</p> <p>-të numërojë veprat tjera të S. Spasses dhe të fitojë një pasqyrë mbi vendin e tyre në letërsinë shqipe;</p> <p>-nëpërmjet të veprës së S. Spasses, të fitojë një pasqyrë mbi rrugën e zhvillimit të romanit shqiptar.</p>	<p>receptimi i veprës, elementet filozofike, romane të personazhit, njeriu i tepërt, njeriu misionar.</p>	<p>-analizohet personazhi i Gjon Zaverit;</p> <p>-shpëgohet subjekti i romanit “Afërdita” dhe nxiten nxënësit të mendojnë rreth temës së romanit dhe mesazhit që përcillet nëpërmjet të kësaj vepre;</p> <p>-analizohet personazhi i Afërditës;</p> <p>-lexohet fragmenti i dhënë (“Nusja pa duvak”) dhe kërkohet që nxënësit ta analizojnë;</p> <p>-pasi të shpjegohen dhe analizohen romanet “Pse” dhe “Afërdita”, nxiten nxënësit që t`i krahasojnë këta dy romane që dallojnë shumë mes veti;</p> <p>-nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet që secili grup, të përzgjedh dhe të analizojë njërin prej këtyre dy personazheve: Gjon Zaverin apo Afërditën;</p> <p>-secili grup i shpreh opinionet e veta dhe hapet diskutim;</p> <p>-në fund jepen informacione për rolin që luajnë romanet e S. Spasses në rrugën zhvillimore të romanit shqiptar.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>10.3. ta kuptojë rolin që luan romani “Pse” në letërsinë shqipe të kohës;</p> <p>10.4. të analizojë personazhin e Afërditës dhe romanin me të njëjtin titull;</p> <p>10.5. nëpërmjet të analizës së fragmentit të dhënë, të njihet me realitetin dhe mentalitetin shqiptar të kohës;</p> <p>10.6. ta kuptojë vendin që zë Sterjo Spasse në letërsinë shqiptare.</p>
11	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e E. Mekulit;</p> <p>-të dallojë fazat e krijimtarisë letrare të E. Mekulit;</p>	<p>Esad Mekuli – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Për ty, Popullit tim , Kush i pari</p>	<p>V eprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Esad Mekulit dhe vendin që zë ai në letërsinë shqipe;</p> <p>-nxiten nxënësit ta analizojnë përmbledhjen poetike “Për ty”, duke u ndalë në motivet dhe temat e cikleve të</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>11.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin që luan dhe vendin që zë poezia e E. Mekulit në letërsinë shqipe;</p> <p>11.2. t`i numërojë dhe emërtojë veprat e E. Mekulit;</p>

	<p>-t`i numërojnë preokupimet tematike të poezisë së E. Mekulit në faza të ndryshme;</p> <p>-ta analizojë përmbledhjen poetike "Për ty";</p> <p>-t`i analizojë poezitë "Popullit tim" dhe "Kush i pari bani";</p> <p>-t`i krahasojë poezitë e E. Mekulit me ato të Migjenit;</p> <p>-të njihet me karakterin e angazhuar të artit të Mekulit;</p> <p>-ta kuptojë vendin e E. Mekulit si bardh i poezisë shqipe në Kosovë.</p>	<p>bani, bardhi i poezisë shqipe në Kosovë, poezi lirike, motivi social, motivi patriotik.</p>	<p>caktuara;</p> <p>-lexohen dhe analizohen poezitë më të njohura të kësaj përmbledhjeje;</p> <p>-analizohen veçmas poezitë: " Popullit tim", "Kush i pari bani" , "Unë", "Porosia e nanës";</p> <p>-diskutohet rreth elementit politik dhe social të poezisë së E. Mekulit;</p> <p>-nxiten nxënësit të diskutojnë rreth rolit që luan poezia e E. Mekulit në zhvillimin e letërsisë shqipe në Kosovë;</p> <p>-meqë nxënësit e kanë të njohur veprën e Migjenit, nxiten të bëjnë krahasim mes poezive sociale të Migjenit dhe të Mekulit;</p> <p>-kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë nga një ese, të motivuar nga poezia e E. Mekulit.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>11.3. t`i identifikojë motivet dhe temat kryesore të poezisë së E. Mekulit;</p> <p>11.4. ta analizojë përmbledhjen "Për ty", gjegjësisht ciklet poetike të saj;</p> <p>11.5. t`i analizojë poezitë më të njohura të kësaj përmbledhjeje, sidomos poezitë që janë dhënë në libër;</p> <p>11.6. t`i dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të poezisë së E. Mekulit;</p>
--	---	--	---	---

Emërtimi i njësisë modulare Edukimi mediatik				
Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-të përkufizojë se çfarë janë mas-</p>	<p>Mediat</p> <p>-Televizioni sot – llojet</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p><u>Ushtrime:</u> diskutim rreth shkrimeve të caktuara nga</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.1. të shpjegojë rolin dhe ndikimin e</p>

	<p>mediat dhe t'i shpjegojnë karakteristikat e llojeve të ndryshme të mediave;</p> <p>-ta kuptojë rolin e mediave dhe të marrë qëndrim kritik ndaj përmbajtjeve që plasohen në media.</p>	<p>e emisioneve, lajmet, lajmet ekskluzive, lajmet e rrejtshme, intervistat.</p> <p>-Roli dhe ndikimi i televizionit si mjet i komunikimit edhe në rrjetet sociale.</p> <p>-Paragjykimet, stereotipet dhe manipulimet në informacionet e dhëna nga mjetet e informimit.</p> <p>-Dekonstruimi i informacionit nga media – anshmëria në informacion.</p>	<p>gazeta ditore dhe revista periodike;</p> <p><u>Ushtrime:</u> kuptimi dhe interpretim i përmbajtjes së lajmit / informacionit të dhënë dhe diskutim rreth lajmit të tillë;</p> <p>-Shfrytëzim i shkrimeve autovizuale si materie për diskutim, ku nxënësit do t'i shprehin qëndrimet dhe opinionet e tyre.</p> <p>Krahasime: mediat sociale; zhvillim i vetëdijes për rolin e informimit dhe objektivitetit të tij,</p> <p>-Informimi në kontekst – nacional, kulturor, personal;</p> <p>-Vlerat, ndikimet, interpretimet dhe kontrolli i mediave.</p> <p>Metoda: metoda interaktive, metoda e komunikimit, metoda e demonstrimit, metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>mediave;</p> <p>1.2. të kuptojë dhe shpjegojë rolin e mediave në krijimin e mendimit publik;</p> <p>1.3. të vlerësojë gjendjen e kulturës mediatike në RM dhe të debatojë në këtë temë.</p>
2	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-ta definojë rolin e reklamës si segment i rëndësishëm i punës së suksesshme afariste;</p> <p>-t'i kuptojë dhe shpjegojë funksionet e reklamës;</p> <p>-të marrë qëndrim kritik ndaj përmbajtjeve të porositve reklamuese.</p>	<p>Reklamat</p> <p>Llojet e reklamave</p> <p>Konceptet: Reklama, reklamuesi, konsumenti.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Ushtime: punë në grupe në krijimin dhe prezantimin e reklamës.</p> <p>Ushtrime: krijimi i porosisë reklamuese .</p> <p>Ushtrime: hartimi i sllajdeve.</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>2.1. ta përkufizojë reklamën;</p> <p>2.2. t'i numërojë karakteristikat dhe funksionet e porosisë reklamuese;</p> <p>2.3. të hartojnë dhe të prezantojnë porositë reklamuese.</p>

<p>Notimi i të arriturave të nxënësve</p>	<p>Notimi është një proces i vazhdueshëm dhe ka për qëllim të siguron informacione gjithëpërfshirëse për të arrituar e nxënësve dhe njëkohësisht t'i përmirëson të njëjtat, gjegjësisht, përparimi dhe notimi i nxënësve i cili monitorohet në vazhdimësi dhe kryhet në kontuinitet gjatë mësimit dhe nënkupton mbledhjen e rregullt të informacioneve të cilat dokumentohen.</p> <p>Notimi i nxënësve ka për qëllim që tua tregojn gjendjen reale të njohurive të tyre dhe t'u jep kahje për përtëhllimin permanent të mëtutjeshëm. Kriteret për notim arsimtari ua sqaron nxënësve dhe në mënyrë konsistente iu pëmbahet të njëjtave gjatë gjithë vitit shkollor. Instrumentet të cilat kanë të bëjnë me pjesën gojore të notimit dhe vlerësimit të nxënësve mund të jenë me përgjigje të parashtruara nga ana e arsimtarit, pyetje të destinuara para përpunimit të veprës, lekturës, si dhe përmbajtjeve nga gjuha, prezantime gojore të temave të caktuara, sjelljen e mendimeve dhe qëndrimeve në lidhje me parashtrimin e pyetjeve problemore në vepër dhe lekturë, diskutim për veprat letrare në kontekst shoqëror, historik dhe letrar, detyra shtëpie, aktivite dhe angazhim në orë.</p> <p>Instrumentet për notim me shkrim lidhen me punime me shkrim, me teste objektive të njohurive, të shkathësive, veçanarisht me teste dhe ese të pavarura nëpërmjet të cilave nxënësit do ta zbatojnë të mësuarën përmes shprehjes individuale. Nxënësit për të arriturat e tyre marrin notë numerike.</p>
<p>Literatura dhe burimet tjera</p>	<p>Tekst mësimorë dhe doracak të lejuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime tjera të të mësuarit.</p>
<p>Fillimi i implementimit të Programit mësimor</p>	<p>Viti shkollor 2021/2022</p>
<p>Institucioni/ bartësi i programit</p>	<p>Byroja për zhvillimin e arsimit</p>
<p>Потпис и датум на донесување на наставната програма</p>	<p>бр. <u>13-11378/8</u> 04-10-2019</p> <div style="text-align: right;">  <p>МИНИСТЕР Dr. Arbër Ademi</p> </div>
<p>Датум на ревизија</p>	